



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:187682  
Datë: 22.04.2024  
Numri i dokumentit: 05601200

**PA1.nr.195/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**, Departamenti i Përgjithshëm – kolegji i përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj - kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Zyhdi Haziri - anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Rrezarta Bala, në çështjen penale ndaj të akuzuarit H. K. , nga J, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 lidhu me par.6 dhe 1, të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit H. K. av. A. H. , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.720/23, datë 26.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit H. K. av. A. H. , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, P.nr.720/23, datë 26.12.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin P.nr.720/23, datë 26.12.2023, të akuzuarin H. K. e ka shpallur fajtor, për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 370 par.8 lidhu me par.6 dhe 1, të KPRK-së dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 140 (njëqind e dyzet) ditësh i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit dhe në bazë të nenit 44 të KPRK-ës i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumë prej nga 2500 (dymijepesëqind) €, të cilën obligohet ta paguajë në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga dita kur ky aktgjykim të merr

formën e prerë. Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguajë dënimin me gjobë atëherë dënimet me gjobë do t'i zëvendësohen në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 (njëzet) € do ti caktohet një ditë burgim. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridik civil. Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguajë shumën prej 150 (njëqindpesëdhjetë) €, për përpilimin e ekspertizës së komunikacionit, shumën prej 50 (pesëdhjetë) €, për përpilimin e ekspertizës mjekoligjore, po ashtu obligohet i akuzuar që të paguaj paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) € si dhe shumën prej 20 (njëzet) € për kompensimin e viktimave të krimit të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

### **Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :**

Mbrojtësi i të akuzuarit H. K. av. A. H. , për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve procedurës, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj sa i përket lartësisë së dënimin dhe shpenzimeve të procedurës, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me gjobë më të butë ose çështjen ta anuloj dhe lënda të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtrësën PPA/II.nr.204/2024, të datës 12.02.2024, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit së të akuzuarit, ndërsa aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

#### **- Ankesa është e pabazuar.**

Edhe pse aktgjykimin i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimin i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të akuzuarit, të cilat do e kishin e kushtëzuar anulimin e tij.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen faktike, andaj aktgjykimin i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

Mbrojtësi i të akuzuarit H. K. av. A. H. e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendimit lidhur me sanksionin penal dhe shpenzimeve të procedurës duke pretenduar që i akuzuari qysh ne shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën e cila i

vihet në barrë, si dhe ka shprehur keqardhje dhe pendim të thellë për rastin që i ka ndodhur. Gjykata si rrethana lehtësuese ka marr parasysh se i akuzuari e ka pranuar fajësinë, faktin se i njëjti është penduar për kryerjen e kësaj veprë, keqardhjen e shfaqur nga ana e të akuzuarit për veprën e kryer, kërkim faljen, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej më vepra penale si dhe faktin se është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin ka marrë shkallën e dëmit të shkaktuar me këtë vepër penale dhe faktin se vepra e kryer përfshin disa të dëmtuar. Gjykata nuk e ka zbatuar fare nenin 69 par.5 të KPRK-së kur ka vendosur për zëvendësimin e dënimit me burgim në dënim me gjobë në shumë prej 2.500 €, nga se sipas kësaj dispozite është përcaktuar se me rastin e caktimi të dënimit me gjobë, gjykata merr parasysh edhe gjendjen pasurore të kryesit dhe posaçërisht merr parasysh shumën e të ardhurave personale, pasurinë dhe detyrimet e tij. Gjykata nuk cakton gjobë në lartësinë që është mbi mundësitë e kryesit. I propozon Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesën të e aprovoj i të bazuar, aktgjykimin e ankimuar të e ndryshoj sa i përket lartësisë së dënimit dhe shpenzimeve të procedurës, ashtu që të akuzuarit të i shqiptoj dënim me gjobë më të butë ose çështjen ta anuloj dhe lënda të i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, për shqiptimin e dënimit më të butë, ndaj të akuzuarit, janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte për shqiptimin e dënimit më të butë, ndaj të akuzuarit. Kështu, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të akuzuarit e duke u bazuar konform të dispozitës së nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, gjykata si rrethana lehtësuese për të akuzuarin mori pranimin e fajësisë nga ana e tij për kryerjen e veprës penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale, keqardhjen e shfaqur nga ana e të akuzuarit për veprimet e ndërmarra, kërkim faljen e tij, premtimin e tij që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe as vepra të tjera, po ashtu faktin si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata mori edhe faktin se për të akuzuarin kjo ishte hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin ngase më parë nuk ka qenë i gjykuar e as dënuar me ndonjë aktgjykim të formës së prerë për ndonjë vepër penale, ndërsa si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori shkallën e dëmit të shkaktuar me veprën penale të kryer nga i akuzuarin sepse si pasojë e veprimeve të akuzuarit lëndime të lehta trupore kanë pësuar B. G. , E. LL.dhe E. LL. 1 ndërsa lëndime të rënda trupore ka pësuar E. LL. 2, po ashtu si rrethanë rënduese për të akuzuarin gjykata mori edhe faktin se vepra penale e kryer nga i njëjti përfshin disa të dëmtuarës përkatësisht 4 të dëmtuar. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e lartcekura gjykata e shkallës së parë i shqiptoi të akuzuarit dënimin sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar me bindjen se edhe me një dënim të tillë do arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa rrethanat e pretenduara lehtësuese në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk janë të atij karakteri dhe nuk kanë ndikim që të akuzuarit t'i shqiptohet një dënim tjetër nga ai të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë apo që akuzuarit të i shqiptoj dënim më të

butë, sikurse që pretendohet në ankesë, të gjitha këto rrethana sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutorë dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve, se me këtë kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tij. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
PA1.nr.195/24, më datë 22.04.2024

**Zyrtarja ligjore;**  
Rrezarta Bala

**Kryetari i kolegjit**  
Skender Çoçaj

**Anëtarët e kolegjit:**  
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri